



INTERSIG®

VIENNA INSURANCE GROUP

Raporti Vjetor

2024



Make life easy!

Struktura e Intersig VIG	4	Tregu i Sigurimeve në Shqipëri - 2024	13
Organizimi i Intersig VIG	5	Intersig VIG në Tregun Shqiptar	14
Historiku i Intersig VIG	6	Tregues për vitin 2024	15
Vienna Insurance Group (VIG)	7	Menaxhimi i Riskut	16-18
Garanci për çdo risk	8	Raporti i Auditit të Brendshëm	19-25
Intersig në Shqipëri	9	Raporti I Pasqyrat Financiare	25-29
Vizioni dhe Misioni i Intersig VIG	10	Plani për 2025	30
Stafi i Intersig	11-12	Kontakt	30

Struktura e Intersig VIG

Intersig Vienna Insurance Group operon në tregun shqiptar prej Tetorit 2001 në fushën e sigurimit të jo-jetës.

Struktura e Këshillit Mbikëqyrës

- | | |
|----------------------|---------|
| • Z. Peter Hoefinger | Kryetar |
| • Z. Christoph Rath | Anëtar |
| • Znj. Liane Hirner | Anëtare |

Struktura e Aksionarëve

- | | |
|--------------------------|--------|
| • Vienna Insurance Group | 89,98% |
| • Z. Gentian Sula | 10,02% |


Struktura e Bordit Drejtues

- | | |
|---------------------|--------------------------|
| • Z. Fitnete Sulaj | Drejtores e Përgjithshme |
| • Znj. Gentian Sula | Anëtar Bordi |
| • Z. Fatmir Bërdica | Anëtar Bordi |

Shoqëri nën zotërim

Intersig VIG zotëron 50% të VIG Services Albania Shpk.

Organizimi i Intersig VIG



* Intersig VIG obtains (transferred) back office services from the company VIG Services Shqiperi, such as: Finance & Accounting; IT and Claim Handling.

** Services shared between two companies: Intersig VIG and Sigma Interlbanian, which are both part of Vienna Insurance Group.

Historiku i Intersig VIG

2001

Intersig u themelua në vitin 2001 nga një grup aksionarësh vendas të cilët morën licencën për një kompani jo-jete në Republikën e Shqipërisë.

2001 – 2011

Intersig pati një rritje të qëndrueshme në market share. Vienna Insurance Group bleu shumicën e aksioneve të Intersig Sha., në bazë të një marrëveshjeje të firmosur në 25 Gusht 2011 në Tiranë.

2011 – Sot

Aktualisht, VIG zotëron 89,98% të aksioneve të Intersig VIG, fakt që ka influencuar në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Intersig VIG ka reformuar shumë procese duke investuar në përmirësimin e kualitetit të stafit dhe digjitalizimin e procedurave në shitjen e produkteve të sigurimit.



Vienna Insurance Group (VIG)

Vienna Insurance Group, me seli të regjistruar në Vjenë, Austri, është një nga grupet më të mëdha ndërkombëtare të sigurimve në Evropën Qendrore dhe Lindore, me mbi 25,000 punonjës në 50 shoqëri të shpërndara në 30 shtete.



Number **1** in CEE

A+
rating with stable
outlook from
Standard & Poor's

WE ARE **NUMBER 1**
IN CENTRAL AND EASTERN EUROPE.

VIG
VIENNA INSURANCE GROUP
Protecting what matters.



* Skano QR Code per informacion.

Garanci për çdo risk

Nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjeve të Risigurimit përsa i përket produkteve të sigurimit jo-jetë, Shoqëria INTERSIG VIG ofron për klientët e saj, në përputhje me Liçensën e Ushtrimit të Aktivitetit, garanci të plotë për çdo risk.

Marrëveshjet e Risigurimit, i mundësojnë shoqërisë transferimin e rrezikut në shoqëritë e mëdha të Risigurimit. Marrëveshjet e Risigurimit mundësohen nga VIG RE si dhe nga Risigurues të tjerë, të gjithë të vlerësuar me "A+" nga Standard & Poor's.

VIG Group vlerësohet me "A+" me një perspektivë të qëndrueshme nga Standard & Poor's (S&P), gjë që e bën Vienna Insurance Group shoqërinë më të vlerësuar në indeksin kryesor ATX të Bursës së Vjenës.

VIG Group është e listuar në Bursën e Vjenës që nga viti 1994, në Bursën e Pragës që nga viti 2008 dhe në Bursën e Budapestit që nga nëntori 2022.

VIG Re, me qendër në Pragë, Çeki, është shoqëria e risigurimit të grupit VIG, e cila mbështet të gjitha shoqëritë e grupit dhe më tej. VIG Re gjithashtu ka një vlerësim "A+" me një perspektivë të qëndrueshme nga Standard & Poor's që nga themelimi i saj në vitin 2008.

Përfshirja në marrëveshje risigurimi i mundëson shoqërisë INTERSIG VIG kapacitete më të lartë të marrjes në sigurim si dhe ofron ekspertizë të dedikuar për risqe të veçanta, duke bërë të mundur që shoqëria të lëshojë polica sigurimi me limite nga më të lartat në treg, për të gjithë linjat e biznesit jo-jetë.

Intersig VIG në Shqipëri


Viti 2024 shënon dhe vitin e 23-të të aktivitetit të Intersig VIG në fushën e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Zyra Qendrore e Intersig VIG gjendet në Tiranë.

Shoqëria operon në bazë të një rrjeti të gjerë të degëve, agjencive dhe pikave të shitjes.

Intersig VIG përfaqësohet në 16 rajone të Shqipërisë.

Në fund të vitit 2024, Shoqëria ka patur një numër total prej 131 punonjësish dhe 185 agjentë dhe agjensi.



Vizioni dhe Misioni i Intersig VIG

Vizioni

Të bëhemi pjesë e një grupi liderësh në fushën e sigurimeve dhe shërbimeve financiare, duke ndjekur rritjen e qëndrueshme dhe duke maksimizuar vlerën e kompanisë. Synojmë të jemi zgjedhja kryesore si kompani sigurimesh, të përkushtuar në edukimin, shërbimin dhe mbrojtjen e familjeve dhe bizneseve , duke ofruar mbulime më të përshtatshme me çmimin të drejtë. Vizioni ynë është të vendosim një standard të lartë cilësie në tregun e sigurimeve, përmes inovacionit, stabilitetit financiar dhe angazhimit maksimal ndaj nevojave të klientëve tanë.

Misioni

Të jemi kompania kryesore në tregun shqiptar falë produkteve konkurruese dhe cilësisë së lartë të shërbimeve që ofrojmë. Çdo ditë veprojmë me ndershmëri dhe përgjegjësi; vlerësojmë larminë dhe përfshirjen; dëgjojmë, mësojmë dhe edukojmë; japim zgjidhje efikase; shpërndajmë energji pozitive dhe qëndrojmë pranë komunitetit tonë. Angazhohemi për inovacion dhe përsosmëri në gjithçka që ofrojmë, duke kaluar përtej pritshmërive të klientëve. Fleksibiliteti dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë parime udhëheqëse për të përmbushur çdo kërkesë të ndryshme të tregut. Ne ndërtojmë vlera të qëndrueshme. Ndjeshmëria ndaj përgjegjësisë sociale (CSR) është arsyeja përse INTERSIG VIG është i përfshirë në projekte sociale, kryesisht personave me mundësi të kufizuara si edhe fëmijëve, të cilët janë e ardhmja jone.

Stafi i Intersig VIG

Një kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të vazhdueshëm brënda dhe jashtë vendit të punonjësve tanë , në mënyrë që t'i ofrojmë klientëve në çdo kohë shërbimin e duhur profesional.



Stafi i Intersig VIG

Një kujdes i veçantë i kushtohet motivimit të vazhdueshëm të punonjësve tanë.
Staff Retreat



Tregu i Sigurimeve në Shqipëri - 2024

- Gjatë vitit 2024, tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë pësoi një rritje prej 7.02% krahasuar me një vit më parë. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur nga 22,896,993 mijë lekë duke arritur në vlerën 24,504,678 mijë lekë.
- Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,595,687, me një rritje prej 8.84 % krahasuar me një vit më parë.
- Tregu mbeti i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.51 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.45%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut Jo Jete sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 32.84% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 67.16% të totalit të tregut Jo Jete .
- Gjatë vitit 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 8,655,975 lekë, ose 24,38 % më shume se në vitin 2023.
- Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për vitin 2024 kapën vlerën 6,238,727 lekë, duke pësuar një rritje me rreth 30.17% krahasuar me vitin 2023.


Intersig Vienna Insurance Group në Tregun Shqiptar

Gjatë vitit 2024, Intersig VIG ka shkruar rreth 2,113 milion lekë prime, duke zotëruar kështu 9.43% të tregut.

Intersig ka paguar rreth 876 milion lekë Dëme gjatë vitit 2024.


Numri i kërkesave të Dëmeve të paguara nga Intersig gjatë 2024 është 11,473 ose 16.39% e të gjithë kërkesave të tregut.

Primet e Shkruara Bruto
Shoqëri Sigurimi të Jo-Jetës




■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Dëmet e paguara në Numër



■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Dëme të paguara në Vlerë



■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Tregues për vitin 2024

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	214.2%
Treguesi në mbulimin e provigjioneve teknike	156.78%


Procesi i Vlerësimit të Riskut

Këto janë risqet (përfshirë dhe kategoritë e nën-risqeve) tek të cilat fokusohet dhe analiza e vetëvlerësimit.

Risku i marrjes në sigurim

Risku operacional

Risku i tregut



Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

Intersig kryen në mënyrë të rregullt vjetore procesin e vlerësimit të riskut të shoqërisë. Për këtë qëllim, është krijuar struktura e brendshme e menaxhimit të riskut të shoqërisë, e përbërë nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut ku përfshihet Komiteti i Menaxhimit të Riskut.

Për kontrollimin dhe vlerësimin e risqeve të shoqërisë, Intersig përdor modelet e shoqërisë mëmë, Vienna Insurance Group. Risqet kryesore të shoqërisë, përveçse janë të identifikuara, kanë po ashtu të përcaktuar frekuencën dhe shkallën e rëndësisë, masat dhe kontrollet e ndërmarra për secilin risk.

1. Risket kryesore të identifikuara:

- Risku i tregut
- Risku i marrjes në sigurim të jo-jetës
- Risku i marrjes në sigurim të produktit të shëndetit
- Rreziku i mospagimit të palës
- Risku Operacional
- Risku i përputhshmërisë ligjore
- Risku i IT dhe sigurisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i reputacionit
- Risku Strategjik etj.

Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

2. Prova e Rezistencës

Vlerësimi dhe klasifikimi i risqeve dhe kryerja e provave të rezistencës bëhet në bazë skenari dhe në bazë ndjeshmërie ndaj ngjarjes. Nga sa më sipër, kryhet llogaritja e nevojave për kapital shtesë në rast se, gjatë vitit të ardhshëm, ndodhin të gjithë skenarët e menduar të situatave katastrofike, epidemike dhe të krizave financiare.

3. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Intersig sigurohet që të mbajë një fond garancie jo më pak se 1/3 e marzhit të aftësisë paguese minimale, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

4. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit

Intersig ka hartuar planin e vazhdueshmërisë së aktivitetit, në të cilin parashikohen skenaret e risqeve të ndryshme të mundshme si dhe masat që duhet të ndërmerren në çdo rast nga personat përgjegjës.

5. Profili i Përgjithshëm i Riskut

Intersig ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen nga pasojat e skenarëve të mësipërm dhe për rrjedhojë, risku i shoqërisë rezulton i menaxhueshëm.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Auditimet dhe kontrollet e kryera

Auditi i Brendshëm ka kryer auditimin përmbledhës për vitin 2024 në shoqërinë e sigurimit INTERSIG VIG, i cili është realizuar bazuar në kërkesat e legjislacionit të AMF për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve, politikat dhe rregulloret e VIG Group, dokumentin "Parimet kryesore të Auditit të Brendshëm të Vienna Insurance Group", rregulloren e AMF "Për veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për shoqëritë e sigurimit", si dhe në rregulloret e brendshme të shoqërisë.

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është kryer bazuar në Planin e Auditimit për vitin 2024, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, duke përfshirë veprimtarinë e shoqërisë kryesisht në fushat e Shitjes, Trajtimit të dëmeve, Administrimit financiar dhe Kontabilitetit, Marrjes në Sigurim, Menaxhimit të Riskut, Risigurimeve, Teknologjisë së Informacionit.

Gjithashtu, janë kryer auditime edhe në veprimtari të tjera të shoqërisë, si në: degët e shitjes, agjentët dhe ndërmjetësit e tjerë të shitjes.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

1. Aktivitetet e Shitjes së Policave të Sigurimit për Produktet e Miratuara dhe të Licencuara nga AMF-ja:

Kontrollet e Auditit të Brendshëm, të cilat janë kryer gjatë këtij viti, janë përqendruar në përputhshmërinë me kërkesat ligjore të AMF-së, rregulloret e brendshme të shoqërisë, kryesisht lidhur me kontrollin e shitjes së produkteve TPL, Karton Jeshil dhe Sigurimi Kufitar. Në këto kontrole, vëmendja është përqendruar tek risqet e mundshme që lindin si pasojë e gabimeve në regjistrimin e policave në programin e shitjes MBA, në përdorimin ekskluziv të këtij programi për shitjen e policave, si dhe në saktësinë e të dhënave që lidhen me kohën e regjistrimit të policës, përputhshmërinë e saj me kategorinë e automjetit dhe periudhën e mbulimit të sigurimit. Gjithashtu, janë kryer kontrole lidhur me arkëtimet e primeve të policave të produkteve vullnetare, si dhe kontrole mbi menaxhimin dhe inventarizimin, kryesisht të policave të detyrueshme. Janë kontrolluar vlerat e primeve për çdo policë, si dhe primi total vjetor në krahasim me numrin e policave të përdorura dhe të shitura gjithsej. Kjo është realizuar në bazë të planifikimit dhe vlerësimit të riskut, si dhe në përputhje me rregulloret e brendshme për administrimin dhe menaxhimin e shitjeve.

2. Aktiviteti i Trajtimit të Dëmeve

Funksionet e menaxhimit dhe trajtimit të dëmeve për dy kompanitë Intersig dhe Sigma, si pjesë e VIG Group, janë transferuar në kompaninë e shërbimit "VIG Services Shqipëri". Kontrollet në Departamentin e Trajtimit të Dëmeve janë kryer në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe legjislacionin në fuqi për tregun e sigurimeve, si dhe në përputhje me politikat dhe udhëzimet e VIG Group, dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë Intersig. Kontrollet janë kryer mbi bazën e vlerësimit të riskut në proceset e trajtimit të dosjeve të dëmeve, duke mbuluar pothuajse të gjitha produktet për dëmet materiale dhe jomateriale gjatë vitit 2024. Kontrollet janë ndarë sipas klasave të sigurimit. Fokus kryesor i kontrollit ka qenë procesi i regjistrimit në kohë dhe plotësimi i dokumentacionit të dëmit, si dhe inspektimi dhe vlerësimi i dëmit. Janë kontrolluar kohëzgjatja e trajtimit të dëmeve dhe zbatimi i afateve ligjore për pagesën e dëmshpërblimit ndaj përfituesve të dëmit apo klientëve. Gjithashtu, është vlerësuar zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregulloreve të AMF-së, si dhe zbatimi i rregulloreve të brendshme të shoqërisë dhe të vetë departamentit të Dëmeve në VIG Services.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

3 – Aktiviteti i Administrimit Financiar, Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar:

Funksionet dhe proceset e punës së administrimit financiar realizohen në zyrat qendrore të kompanisë Intersig VIG, ndërsa departamenti i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar ushtron veprimtarinë e tij në kompaninë e shërbimeve VIG Services Shqipëri.

Gjatë vitit 2024, kontrollet në departamentin e Administrimit Financiar janë fokusuar në menaxhimin dhe administrimin e policave të sigurimit për të gjitha proceset që kalon një policë siguri në programin MBA, si: furnizimi dhe shpërndarja e policave, regjistrimi në programin e shitjes nga departamenti i shitjes, agjentët, zyrat dhe ndërmjetësit e tjerë të shitjes, deri te arkëtimi i primeve dhe rakordimet përkatëse.

Temat kryesore të audituara për vitin 2024 kanë qenë: raportet për menaxhimin e primeve, arkëtimin e tyre, raportet e debitorëve dhe të inventarit fizik dhe kontabël të policave të detyrueshme të nxjerra nga programi i shitjes MBA. Janë kryer gjithashtu kontrolle në lidhje me llogaritjen e komisioneve bazuar në kërkesat ligjore të AMF-së, si dhe në përputhje me urdhrat e brendshëm të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë.

Në veprimtarinë e Kontabilitetit në VIG Services, kontrollet janë përqendruar në saktësinë e regjistrimeve në programin SAP, për primet e shkruara, primet e arkëtuara dhe balancat e hapura debitorë për primet e paarkëtuara, në nivel kompanie, dege dhe agjentësh të tjerë shitjeje. Janë kontrolluar rakordimet mujore dhe vjetore të nënshkruara nga të dy departamentet, të cilat synojnë krahasimin e të dhënave dhe treguesve të raportuar në programin SAP me ato të raportuar në programin MBA.

Nga kontrolli ka rezultuar se të dhënat janë korrekte dhe të nënshkruara nga personat përgjegjës për të dyja palët.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

4-Aktivitetet e Marrjes ne Sigurim dhe te Menaxhimit te Rriskut.

Aktiviteti per keto dy departamente eshte bere kryesisht me Marrjen ne sigurim te produkteve vullnetare si per Pronat, Pergjegjesite , Garancite e tjera. Jane bere kontrole lidhur me treguesit dhe nivelet e marrjes ne sigurim, dhe te percaktimit te rrisqeve per cdo product, dhe per cdo kontrate sigurimi te caktuar. jane kryere kontrollet lidhur me te dhenat dhe analizen e klientit dhe me pershkrimin dhe analizen e prones. Vleresimi dhe Menaximi i rriskut kryehet nga Komiteti i Menaxhimit te rriskut. ky Komitet kontrollon dhe miraton vleresimin e rriskut dhe ofertat per vleresimin e primit te marrjes ne sigurim, bazuar ne rregulloret e brendshme dhe ne urdherat e udhezimet e Bordit Drejtues te shoqerise, si dhe ne pershtatje me kerkesat e tregut te sigurimeve.e te kerkesave Ligjore te AMF.

5-Aktivitetet e Risigurimeve.

Keto aktivitete kryen nga Departmenti Risigurimeve Share services , i cili kryen funksionet e tij te sherbimit per kontrata TREATY per dy shoqerite e sigurimit Intersig VIG dhe Sigma VIG. Partneri kryesor i shoqerise per aktivitetin e risigurimeve eshte VIG-RE i cili eshte pjese e Vienna Insurance Group Ky department ka per objekt kryerjen e risigurimeve te shoqeris Intersig VIG si dhe pergatitjen e raporteve per mareveshjeve te risigurimit, kontrollin e kushteve te kontratave te Risigurimit per marreveshjet Fakultative dhe mareveshjet Fronting. dhe ne bashkepunim me Departamentin e Marrjes ne sigurm kryen harmonizimin e ketyre kushteve me kerkesat e tregut lokal ne Shqiperi. Auditimi dhe kontrollet jane kryere kryesisht me miratimin e limitit te cedimeve te Primit per kompanite e grupit ku ben pjese edhe shoqeria Intersig kjo bazuar ne rregulloret e Grupit vig. te percaktuara nga departamenti VIG Grup.. Ne Shoqerine INTERSIG Kontrollet jane fokusuar tek marveshjeve te risigurimeve Fakultative dhe Fronting.per te cilat te gjitha proceset e risigurimit kryhen direkt nga kompania Intersig. Jane Kryere auditime per temat lidhur me periudhen embulimitne marreveshjet e Risigurimit, dhe ka rezultuarse periudha e mbulimit ne sihurime neneshkruarne Marveshjet Fakultative me Risiguesin eshte e njejte me periudhen e mbulimitne policen e risiguruarsidhe me marveshjenme klientet dhe , qse subjeket e risiguar.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

6-Aktiviteti i menaxhimit të riskut –Sistemi qeverisjes së shoqërisë.

Auditimi u fokusua në proceset e punës që kryhen për hartimin e strategjisë së menaxhimit të riskut, procese si: identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i rrisqeve si dhe masat e mara për parandalimin dhe zbutjen e tyre. Monitorimi dhe raportimi, ka qenë në pajtueshëri me kërkesat rregullatore të AMF, dhe me politikat e grupit VIG, si dhe me rregulloret e udhëzimet e shoqërisë. Menaxhimi i riskut si pjesë e sistemit të qeveriajes ka luajtur rol efektiv në qëndrueshmëri dhe rritjet financiare, si dhe ka mbështetur objektivat strategjike dhe operative të shoqërisë për vitin 2024.

7.Aktivitetet e departamentit Ligjor.

Auditimet e kryera në aktivitetet juridike e ligjore gjatë vitit 2024 janë fokusuar në, Parandalimin, mbrojtjen dhe përfaqësimin e shoqërisë në proceset Gjyqësore me palët e treta persona fizike dhe juridike. Janë kontrolluar trajtimi i dosjeve të dëmeve Gjyqësore, për mbrojtjen e bërë në gjykate, dhe për dënimin e mendimeve juridike për menyrat dhe rruget sa më efektive të zgjidhjeve të çështjeve bazuar, në variantet me zgjidhje me marrëveshje ndërmjetësimi pa kaluar në proces gjyqësor, Janë audituar edhe përfaqësimet e juristëve të kompanisë lidhur me grumbullimin dhe atëkëtimet e primeve të paarkëtuara, nga kliente fizike dhe subjekte debitorë. Gjithashtu janë audituar edhe ndjekja e procedurave të dëmeve të regresit lidhur me arkëtimet ndaj klientëve për shumat e përfituara nga pagesat e dëmeve sipas kërkesave ligjore.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktiviteti i Administrimit Financiar te primeve, dhe te Kontabilitetit & Raportimit Financiar

Departamenti i Administrimit financiar e kryen veprimtarine e vetë në zyrat qendrore të kompanise Intersig VIG, kurse departamenti i kontabilitetit dhe Raportimit financiar të shoqërisë e kryen veprimtarinë e tij në kompanine e shërbimit VIG Services. Për vitin 2022 kontrollet në departamentin e Administrimit Financiar janë fokusuar në administrimin e policave për të gjitha proceset që kalon polica e sigurimit në programin MBA, pasi policat rregjistrohen nga departamenti i shitjes si dhe nga agjentet ,zyrat dhe ndërmjetesit e tjerë të shitjes deri në arkëtimin e primeve dhe në rakordimet përkatëse. Temat kryesore të kontrolluara për vitin 2022 kanë qënë ,raportet në nivel police dhe agjenti, për menaxhimin e primeve , arketimit të primeve, te debitoreve , te inventarit fizik dhe ate të rregjistruar në progrmin MBA për administrimin të policave të sigurimit. Janë kryer kontrole lidhur me llogaritjen e komisioneve në përputhje me urdhrat e brëndshme të Bordit te Drejtoreve te shoqërisë si dhe ne zbatimin e procedurave per leshimin e policave dublikate dhe te policave te anul luara. Kontrole jane ushtruar edhe me rakordimet nga ana e departamentit me agjentet, degët dhe ndërmjetesit e tjere të shitjes lidhur me primet e policave të shitura, me arketimin e primeve, me debitoret e tjera.

Në departamentin e Kontabilitetit në VIG Services kontrollet janë fokusuar lidhur me saktësinë e regjistrimeve në programin SAP, të primeve te shkruara, të primeve të arketuara, dhe të balancave të hapura debitore për primet e pa arketuara, ne nivel kompanie, degeve, agjenteve e ndërmjetësve të tjerë të shitjes. Janë kontrolluar rakordimet mujore dhe vjetore te cilat kryen nga departamenti i Kontabilitetit dhe raportimit finaciar VIG Services, me departamentin e Administrimit në shoqerine Intersig rakordimi kryhet për krahasimin e të dhënave dhe treguesve të raportuara në programin SAP me të dhënat dhe treguesit e raportuara në programin MBA. Nga kontrolli ka rezultuar se të dhënat janë korrekte dhe të nenshkruara nga personat përgjegjës për të dyja palët.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktivitetet e Marrjes në Sigurim dhe të Menaxhimit të Riskut

Aktiviteti për këto dy departamente është kryer kryesisht në lidhje me marrjen në sigurim të produkteve vullnetare, si për Pronat, Përgjegjësitë, Garancitë e tjera.

Gjatë procesit të marrjes në sigurim janë kryer kontrole në lidhje me të dhënat dhe analizën e klientit, përshkrimin dhe analizën e pronës, si dhe treguesit e tjerë të rëndësishëm për marrjen në sigurim dhe përcaktimin e risqeve për çdo produkt, pronë, përgjegjësi apo tjetër, sipas kontratës përkatëse të sigurimit.

Kontrollet janë kryer gjithashtu në lidhje me plotësimin e formularëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për marrjen në sigurim, si dhe me regjistrimin apo plotësimin në programin MBA të dokumenteve kryesore të këtij procesi, bazuar në rregulloren e brendshme të marrjes në sigurim.

Analizat, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut kryhen nga Komiteti i Menaxhimit të Riskut. Për çdo rast sigurimi, në varësi të kufijve të shumës së sigurimit dhe nivelit të miratimit, Komiteti i Menaxhimit të Riskut bën vlerësimin përkatës dhe përgatit ofertat për vlerën e primit të sigurimit, bazuar në rregulloret e brendshme dhe në urdhrat e udhëzimet e Bordit Drejtues të shoqërisë.

Opinion i Shoqërisë Audituese



Grant Thornton Sh.p.k
Rr. "Samë Freshit",
Kompleksi T.I.D, Shk. B, Floor 1
1001 Tirana
Albania
T +355 44 525 880
E contact@gt.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e "Intersig Vienna Insurance Group" sh.a,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Intersig Vienna Insurance Group" sh.a. (këtu e më poshtë referuar "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2024, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2024, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontablistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontablistët (IESBA), kërkesat elike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera të marrë në datën e këtij raporti auditimi janë "Aneke shoqëruese suplementare", por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to. Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Sikurse është paraqitur në anekset suplementare Shoqëria ka llogaritur marzhin mbi aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me politikat kontabël të përshkruara në Shënimin 2 si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë

Opinion i Shoqërisë Audituese

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm. Marrim një kuptuesmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

31 mars 2025



Auditor Ligjor

Erjona Isafi

Pasqyrat Financiare

Pasqyrat Financiare sipas Standardeve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Skedulet
Suplementare më 31 dhjetor 2024

Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET		
Aktivitet afatgjata materiale	7 224,842	242,621
Aktivitet afatgjata jo-materiale	8 9,103	11,280
Aktive me të drejtë përdorimi	9 29,883	27,459
Aktive të mbajtura për investime	10 156,960	142,780
Investime në pjesëmarrje	11 24,601	24,601
Aktive të risigurimit	12 1,148,764	1,000,310
Letra me vlerë të mbajtura me koston e amortizuar	13 1,473,600	1,406,200
Depozita me afat në banka	14 1,115,184	999,924
Aktive të tjera	15 22,933	22,001
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	16 243,473	223,514
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	17 51,586	108,841
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	18 199,387	162,892
TOTALI I AKTIVEVE	4,700,316	4,372,422
KAPITALI		
Kapitali aksionar	19 417,471	417,471
Rezerva ligjore e sigurimit	19 41,747	41,747
Fitime të mbartura	461,464	413,283
TOTALI I KAPITALIT	920,682	872,501
DETYRIMET		
Rezervat teknike të sigurimit	20 1,586,499	1,475,148
Rezerva për primet e pafituara	21 1,045,010	937,055
Depozita e risigurve	22 958,501	861,452
Detyrime për qira	30,513	27,403
Detyrime tatimore	23 27,266	27,569
Tatim fitimi i pagueshëm	3,247	5,053
Llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	24 128,598	166,241
TOTALI I DETYRIMEVE	3,779,634	3,499,920
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE	4,700,316	4,372,422

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më datë 27 mars 2025 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Fitnete Sulaj
Intersig Vienna Insurance Group sh.a

INTERSIG
VIENNA INSURANCE GROUP
NIPT: K12201002T

Ilir Elprazi
VIG Services SH.P.K.

Shënimi	2024	2023
Prime të shkruara bruto	25 2,113,620	1,931,521
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	21 (107,955)	(42,125)
Të ardhura nga primi i sigurimit	2,005,665	1,889,396
Prime të ceduara të risigurve	26 (901,426)	(813,468)
Ndryshimi në rezervën e risigurve për primin e pafituar	21 56,835	11,648
Prime të ceduara të risigurve	(844,591)	(801,820)
Prime të fituara neto	1,161,074	1,087,576
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	27 344,595	385,037
Të ardhura nga investimet	28 115,576	87,884
Të ardhura të tjera operative	29 6,080	4,679
Të ardhura neto	1,627,325	1,565,176
Dëme të paguara, bruto	(916,989)	(636,640)
Dëme të arkëtuara nga risigurve	425,283	221,563
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	(111,351)	(95,713)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risigurve	91,619	2,016
Dëme dhe përfitime të sigurimit, neto	(511,438)	(508,774)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	30 (500,722)	(460,574)
Shpenzime administrative	31 (331,476)	(336,108)
Shpenzime të tjera nga aktiviteti i sigurimit	32 (40,793)	(41,018)
Shpenzimet	(872,991)	(837,700)
Shpenzime financiare	33 (29,541)	(26,456)
Humbje nga kurset e këmbimit, neto	34 (21,886)	(31,227)
Shpenzime të tjera	191,469	161,019
Fitimi para tatimit	35 (30,244)	(28,025)
Tatimi mbi fitimin	161,225	132,994
Fitimi i vitit	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	161,225	132,994

Pasqyrat Financiare

	Shënimi	2024	2023
Fitimi para tatimit		191,469	161,019
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	32	46,457	52,708
Zhvlerësimi i aktive të mbajtura për investime	32	-	-
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	32	-	6,500
Humbje nga shitje e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime interesi		24,496	21,090
Të ardhura nga investimet		(115,576)	(87,884)
Efekti nga kursi i këmbimit		-	-
Flukset monetare nga aktiviteti operativ para ndryshimeve në aktive dhe detyrime		146,846	153,433
Ndryshime në aktive të risigurimit		(148,454)	(13,664)
Ndryshime në aktive të tjera		(932)	50,860
Ndryshime në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		(19,958)	(21,026)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		(57,254)	(30,362)
Ndryshime në rezervat teknike të sigurimit		111,351	95,713
Ndryshime në rezervën e primeve të paguara		107,955	42,125
Ndryshime në depozitën e risiguresit		97,049	59,459
Ndryshime në detyrimet tatimore		(302)	2,353
Ndryshime në llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		(37,643)	55,186
Flukset monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ		166,320	240,644
Interesi i arkëtuar		80,115	63,743
Tatimi mbi fitimin i paguar		(32,050)	(27,039)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		361,231	430,781
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(3,474)	(6,352)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	9	(1,000)	(1,533)
Blerja e letrave me vlerë të investimeve me kosto të amortizuar	14	(182,859)	(303,342)
Maturimi i investimeve me kosto të amortizuar	14	100,000	115,000
Ndryshime në depozitat me afat në banka		(113,011)	(141,046)
Ulje në investimet në pjesëmarrje		-	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(200,344)	(337,273)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Pagesat e qirave	10	(14,203)	(15,273)
Dividendi i paguar	20	(113,044)	(93,764)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet finacuese		(127,247)	(109,037)
Translation effect		2,855	23,400
Rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		36,495	7,871
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit	19	162,892	155,021
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	19	199,387	162,892

Objektivat 2025

Primet e shkruara	
Produkti	Vlera (në mijë lekë)
TPL	1,270,000
Kartoni jeshil	215,000
Kufitare	68,000
Kasko	123,000
Aksidente Personale	28,000
Sigurim Prone	160,000
Sigurim Pergjegjesie	44,000
Sigurim Garancie	36,000
Mall ne Transport	3,000
Shendet ne udhetim	7,000
Sigurim Shendeti	122,000
Pergjegejsi Avion	10,000
Kasko Avion	15,000
Pergjegejsi Anije	2,000
Kasko Anije	3,000
Grand Total	2,106,000



make life easy

KONTAKT

Dega Qendrore

Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Samos Tower,
Kati i 2-të, Ish-Bllok, Tirane.

Tel: +355 (0) 4 22 70 576

E-mail: info@intersig.al